



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Aksidenti tragjik në Lushnje, automjeti del nga ruga dhe përfundon në kanal! 2 motra humbin jetën, u mbytën nga uji (VIDEO)
- 2

"Turizmi i lindjeve" në SHBA, Trump firmos 2 urdhra për të ndaluar! Jo më nënshtetësi automatike për foshnjat
- 3

Norvegjia kërkon dorëheqjen e Infantinos. Meksika dhe Argjentina mbështesin presidentin e FIFA-s
- 4

Ben Blushi: A mund të bëhet Shqipëria një shtet më i madh sipas Marko Rubios?
- 5

Ishte me pushime me familjen, ish-kreu i Gjykatës së Vlorës Skënder Haluçi shuhet në moshën 64-vjeçare

Kronikë

Tiranë/ Plumba drejt të miturit pas sherrit, 4 në pranga dhe 2 në kërkim (EMRAT)

Dyshohet se 34-vjeçari Rolf Fezollari ka fyer një të mitur duke e nxitur atë dhe miqtë e tij të konfliktosheshin fizikisht mes tyre. 17-vjeçari ka shkuar më pas me motor te banesa e vëllezërve Rolf e Stiven Fezollari, por vëllai tjetër i tyre, Frenki, i ka qëlluar me armë zjarri, pa lënduar njeri.



Redaksia

13 Gusht, 14:18 | Përditësimi: 13 Gusht, 15:00

f Share

Post


WhatsApp



Për konfliktin e dy ditëve më parë në Tiranë, policia ka identifikuar 10 persona dhe arrestuar 4 prej tyre. Në pranga janë Rezar Zaimi, Kevin Kocibellinj, Stiven Fezollari dhe Rolf Fezollari.

Frenki Fezollari dhe Cercis Brahimllari, të dy 32 vjeç, janë shpallur në kërkim, kurse 4 të tjerë janë nën hetim.

Dyshohet se 34-vjeçari Rolf Fezollari ka fyer një të mitur duke e nxitur atë dhe miqtë e tij të konfliktosheshin fizikisht mes tyre. 17-vjeçari ka shkuar më pas me motor te banesa e vëllezërve Rolf e Stiven Fezollari, por vëllai tjetër i tyre, Frenki, i ka qëlluar me armë zjarri, pa lënduar njeri.



LEXO EDHE: 14 vatra zjarri aktive në Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes: Situatë e rënduar në Gurë-Lurë të Dibrës dhe Elbasan! Flakët në 'kuroren' e Tiranës vihen nën kontroll

Brahimllari është në kërkim për përkrahje të autorit dhe moskallëzim krimi. Për të njëjtën veprë është arrestuar Rezar Zaimi që iu gjet edhe thikë, tashmë e sekuestruar. Kevin Kocibellinj akuzohet për përkrahje të autorit dhe veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës. Kjo veprë rëndon edhe mbi dy vëllezërit e arrestuar.

Njoftimi i policisë:

Finalizohet operacioni i koduar “Situata”.

Zbardhen përfshirja dhe rrethanat e konfliktit ndërmjet disa shtetasve, rreth mesnatës së datës 11 gusht, në rrugën “Gjolekë Kokona”, ku dhe u qëllua me armë zjarri.

Identifikohen 10 shtetasit e përfshirë. Vihen në pranga 4 prej tyre, procedohen penalisht 4 dhe shpallen në kërkim 2.

Sekuestrohen nga vendngjarja, 1 mjet prerës (thikë) dhe sende të tjera që do t’i shërbejnë hetimit.

Menjëherë pas njoftimit se disa shtetas ishin përfshirë në një konflikt në rrugën “Gjolekë Kokona”, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4 shkuan në vendngjarje për të përcaktuar shtetasit e përfshirë në konflikt, përgjegjësitë e tyre, si dhe rrethanat e rastit.

Në vijim të veprimeve hetimore dhe procedurale të kryera në kuadër të operacionit të koduar “Situata”:

-u arrestuan shtetasit R. Z., 28 vjeç, për veprat penale “Përkrahja e autorit”, “Moskallëzimi i krimit” dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”; K. K., 31 vjeç, për veprat penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” dhe “Përkrahja e autorit të krimit”, si dhe S. F., 24 vjeç dhe R. F., 34 vjeç, për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”;

-u proceduan në gjendje të lirë, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, 4 shtetas gjithashtu të përfshirë në konflikt;

-u shpallën në kërkim shtetasit F. F., 32 vjeç, për veprat penale “Vrasja me dashje”, mbetur në tentativë, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, dhe C. B., 32 vjeç, për veprat penale “Moskallëzimi i krimit” dhe “Përkrahja e autorit të krimit”.

Nga veprimet hetimore të deritanishme dyshohet se shtetasi i arrestuar R. F. ka fyer një të mitur të proceduar në gjendje të lirë. Si pasojë, 17-vjeçari dhe miq të tij janë konfliktuar fizikisht, me shtetasin R. F., vëllanë e tij, shtetasin S. F., dhe me miq të këtyre të fundit. Më pas, i mituri dhe miqtë e tij kanë shkuar me motomjete, te banesa e vëllezërve, nga ku dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri, në drejtim të motomjeteve, vëllai tjetër i tyre, shtetasi i shpallur në kërkim, F. F., pa dëmtuar askënd.

Punohet për kapjen e 2 shtetasve të shpallur në kërkim, si dhe për dokumentimin me prova ligjore të rrethanave të këtij rasti.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Lajm në përditësim...

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

P.J/Shqiptaria.com

TAG:

Tirane

arrestim

Sa e vlerësoni këtë artikull?



1.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: A mendoni se Shqipëria është e përgatitur për sezonin e zjarreve?

9 Gusht, 17:40

Po

Jo

I/e dyzuar

Lajme të tjera




Çarja e tubacionit të ujit në Unazën e Madhe në Tiranë, Ujësjellësi: Furnizimi me ujë për Lundrën e Daiasin rikthehet në 2 orë e ardhshme

13 Gusht, 17:33



Ndryshon numri i Shërbimit të Klientit të IdentiTek, ja ku mund të telefonojnë qytetarët për shërbimet e pasaportave dhe kartave të identitetit

13 Gusht, 16:13



Kosovë/ Arrestohet një person në Merdar nën dyshimin për spiunazh të Serbisë

13 Gusht, 15:09



Zjarri në Priskë, shiu u vjen në ndihmë zjarrfikësve për izolimin e vatrës

13 Gusht, 14:56



Zjarri në Priskë, Meta: Të investohet më shumë në blerjen e mjeteve e avionëve zjarrfikës! Blushi thirrje Ramës dhe ministrave: Ndërprisni pushimet e dilni në terren (VIDEO)

13 Gusht, 13:59



Zjarri, qytetari: Flakët nisën fillimisht në Priskë, më pas u hapën si pasojë e erës (VIDEO)

13 Gusht, 13:41



Zjarret në Tiranë, prefekti Hajdari për Report Tv: 5 vatra në kryeqytet, dyshohen të qëllimshëm! Kemi një përmirësim

13 Gusht, 13:22



PD s'e njej Avokatin e Popullit, por i kërkon hetim për 'Smart City'! Shabani: Faleminderit për besimin

13 Gusht, 12:34




Punimet për autostradën, bllokohet aksi Tiranë-Durrës natën midis 14-15 gushtit! Nuk pengohet lëvizja drejt aeroportit

13 Gusht, 11:52




Tiranë/ Shpërthen tubacioni i ujit në Unazën e Madhe, kufizime të pjeshme të furnizimit në Daia e Lundër! Nuk preken zona të tjera (VIDEO)

13 Gusht, 11:16



Kanosi grupin e gazetarëve gjatë xhirimit të një kronike, arrestohet 64-vjeçari në Tiranë! I gjendet edhe një armë pa leje (VIDEO)

13 Gusht, 11:09



Zjarri në Tiranë/ Përmirësohet situata në fshatin Daia, po punohet nga toka dhe ajri (VIDEO)

13 Gusht, 08:08

Lajmi i fundit



‘Karamelo’ në mes të bulevardit kryesor në Durrës, instalacioni i veçantë para godinës së bashkisë (VIDEO)

13 Gusht, 20:34



Lajmi i fundit



‘Karamele’ në mes të bulevardit kryesor në Durrës, instalacioni i veçantë para godinës së bashkisë (VIDEO)

13 Gusht, 20:34